



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Rahovecit**  
**Opština Orahovac / Municipality Rahovec**  
**Drejtoria për Arsim**



Nr. i Protokollit: 04/352

Datë: 05.07.2022

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimi i përkohshëm, nenit 84 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, dhe rekomandimit të Komisionit Nr. 349 i datës 01.07.2022, Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit bën këtë:

## **N J O F T I M**

Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit bën anulimin e konkursit Nr. 04/223 të datës 05.05.2022 të shpallur nga Drejtoria për Arsim, në web-faqen e Komunës së Rahovecit, për titullin e vendit të punës Drejtor/eshë në SHFMU "Skënder Kastrati" në Radostë.

### **Arsyetim**

Anulimi i konkursit të lartpërmendur bëhet për shkak se kandidatët të cilët kanë konkuruar në këtë konkurs nuk i kanë pasur dokumentet e kompletuara sipas kërkesave të konkursit dhe Udhëzimit Administrativ të (MASH) Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimi i përkohshëm.

Rishpallja e konkursit do të bëhet brenda afateve ligjore.



**Avni Morina**

*Avni Morina*  
**Drejtore**